



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

---

Numri i lëndës: 2023:213651

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06733875

C.nr.885/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Lirika Sylaj në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. M nga fshati K, Komuna e Istogut, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shqipdonë Maraj - Ferizaj avokate në Istog, kundër të paditurit E. (B) H. me adresë të pa njohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Getuar Zekaj avokat në Istog, me objekt të kontestit pengim posedimi në servitutin e kalimit, jashtë seancës gjyqësore të datës 21.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit A. M nga fshati K, Komuna e Istogut, e identifikuar nën shenjën C.nr.885/23, e parashtruar në këtë gjykatë me datën 09.10.2023, kundër të paditurit E (B) H me adresë të pa njohur, me objekt të kontestit pengim posedimi në servitut kalimi.

II. Përfaqësuesit të përkohshëm Av. Getuar Zekaj, i njihen shpenzimet gjyqësore të krijuara në emër të shpenzimeve në cilësinë e përfaqësuesit të përkohshëm dhe atë në shumën e përgjithshme prej 509.60 Euro, për çka gjykata me vendim të veçantë do të urdhëroj arkën e kësaj gjykate që të deponoj këto mjete në xhirollogarinë e përfaqësuesit të përkohshëm, nga shuma e mjeteve të deponuara pranë kësaj gjykate nga paditësi, në emër të pagesës për përfaqësues të përkohshëm.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes përfaqësueses së autorizuar në këtë gjykatë me datën 09.10.2023 ka parashtruar padi, kundër të paditues M. Rr me objekt të kontestit pengim posedimi në servitut kalimi.

Përgjatë procedurës e njëjta e ka tërhequr padinë kundër të paditurës M. Rr ashtu që tutje në cilësinë e të paditurit të jetë E (B) H.

Mirëpo, me parashtresën e dorëzuar në këtë gjykatë me datën 09.01.2025 përfaqësuesja e autorizuar e paditësit av. Shqipdon Maraj – Ferizaj, e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë me bazë juridike pengim posedimi pasi që palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje sa i përket kësaj çështje dhe se tani me kanë pushuar shkaqet që kjo procedurë të vazhdojë.

Gjykata me tërheqjen e padisë e ka njoftuar përfaqësuesin e përkohshëm të palës së paditur av. Getuar Zekaj, e i cili me parashtresën e datës 14.01.2025 e ka njoftuar gjykatën se nuk e kundërshton tërheqjen e padisë lidhur me këtë çështje duke i kërkuar shpenzimet procedurale dhe atë për 3 seanca gjyqësore nga 135,20 Euro dhe për përgjigje në padi 104 Euro e në shumën totale prej 509,60 Euro.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurën kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 par.1 të LPK-së, e cila parasheh që: “Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”. Si dhe par.2 i këtij neni ku parashihet se “Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”

Meqenëse në rastin konkret përfaqësuesi i përkohshëm i palës së paditur nuk e ka kundërshtuar tërheqjen e padisë, ndërsa në anën tjetër nga shqyrtimi kryesor i mbajtur për këtë çështje me datën 25.09.2024 në të cilën seancë përfaqësuesja e autorizuar e palës së paditur i ka dorëzuar gjykatës parashtresën mbi precizimin e kërkesëpadisë në aspektin subjektiv ashtu që në vend të paditurit E. H të jetë A. (B) H, gjykata deri në këtë fazë nuk e ka lejuar një precizim të tillë, andaj edhe vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 paragrafi 3 të LPK-së, e cila përcakton se: “Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke iu referuar dispozitave ligjore nga neni 81 paragrafi 2 si dhe neni 82 paragrafi 1, duke ia njohur av. Getuar Zekaj shpenzimet procedurale në emër të përfaqësimit në cilësi të përfaqësuesit të përkohshëm dhe atë për 3 seanca gjyqësore nga 135,20 Euro dhe për përgjigje në padi 104 Euro e në shumën totale prej 509,60 Euro.

Andaj, në një gjendje të këtillë, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA NË ISTOG**

Departamenti i përgjithshëm

Divizioni për Çështje Civile

Gj y q t a r j a

Lirika Sylaj

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.